



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmjenol/Prodato Received/Delivery	03.08.2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPICAK	4510/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.550/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.550/2022 të datës 20.06.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi

kundër organit të punësimit/Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 03.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar me ankesën A.nr.550/2022 e datës 20.06.2022 të parashtruar nga ankuesi.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën “Udhëheqës i Sektorit Ligjor” sipas akt emërimit me nr.01.Nr.112-1024 të datës 01.02.2017 në Komunën e Prishtinës me datë 20.06.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës kundër vendimit me nr.14-020/01-108671/22 të datës 17.05.2022 të nxjerr nga Kryetari i Komunës së Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datë 24.06.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Komuna e Prishtinës, ndërsa me datë 01.07.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër A.nr.550/2022 me numër të protokollit 3590/2022 të parashtruar nga ankuesi me datën 20.06.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 17.05.2022 me nr.14-020/01-108671/22 i nxjerr nga kryetari i Komunës së Prishtinës; Vendimi A.nr.316/2022 i datës 11.05.2022 me numër protokollit 2722/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; akt emërimit me nr.01.Nr.112-1024 të datës 01.02.2017; Çertifikatë e prokurimit 2015-2017; Çertifikatë e datës 04-05.03.2015; Çertifikatë e datës 27.04.2016; Çertifikatë e datës 05-06.05.2015; Çertifikatë e datës 13.05.2015; Çertifikatë e datës 08.05.2015; E-mail zyrtar i datës 01.06.2022; Plotësimi i ankesës me datë 06.07.2022 bashkë me këto shkresa : e-mail i datës 01.06.2022 - njoftim; e-mail zyrtar i datës 20.05.2022; e-mail zyrtar i datës 02.06.2022; e-mail zyrtar i datës 30.06.2022; Vendimi i datës 31.05.2022 me nr.14-117/01-122044/22 i nxjerr nga Kryetari i Lpmunës së Prishtinës; Pasqyra e llogarisë së trustit prej dt.29.10.2021 deri më dt.03.07.2022; përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 01.07.2022 me numër protokollit 3850/2022 bashkë me shkresat e lëndës; propozim për transferim të shërbyesit civil i datës 16.08.2018; Vendimi për pezullim të dakorduar i datës 16.08.2017; E-mail zyrtar i datës 25.07.2022 ; Diploma e Fakultetit Juridik të datës 18.03.2015 me numër 3053 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina; Statuti i Qendrës për punë sociale miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës 01.nr.110-158, me datë 27.01.2011 dhe Përshkrimi i detyrave të punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale lidhur me objektin e kësaj ankese, ka konstatuar që përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës së ankuesit **SEPSE:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka gjetur se ankuesi me datë 31.03.2022 i është drejtuar me ankesë A.nr.316/2022 Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për kthimin në pozitën "Udhëheqës i Sektorit Ligjor "në Komunën e Prishtinës pas përfundimit të mandatit si Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës.

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi është caktuar në pozitën Udhëheqës i Shërbimeve Sociale sipas Aktit të Emërimit me numër 01-112-1022 të datës 01.06.2022 i lëshuar në zbatim të Vendimit A.nr.316/2022 të datës 11.05.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ndërlidhur me këtë çështje, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil ka shqyrtuar dhe ka vendosur lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.316/2022 të datës 31.03.2021 duke obliguar Kryetarin e Komunës së Prishtinës, që nga dita e pranimit të këtij vendimi brenda afatit ligjor prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh të bëjë zbatimin e tij duke e kthyer nëpunësin në pozitën e mëparshme "Udhëheqës i Sektorit Ligjor" në Departamentin e Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës sipas Akt Emërimit 01.Nr.112-1024 të datës 01.02.2017 ose në një pozitë ekuivalente.

Kryetari i Komunës së Prishtinës me Vendimin me nr.14-020/01-108571/22 i datës 17.05.2022 ka zbatuar vendimin e Këshillit A.nr.316/2022 me numër protokollit 2722/2022 të datës 11.05.2022 duke emëruar të njëjtin në pozitë ekuivalente sipas pozitës që kishte më herët respektivisht në pozitë të Udhëheqësit të Shërbimeve Sociale në Qendrën për Punë Sociale që

funksionon në kuadër të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale nga se në pozitën e mëparshme që ankuesi kishte sipas aktemrimit respektivisht pozitën "Udhëheqës i Sektorit Ligjor" ishte caktuar një zyrtarë tjetër përmes procedurës së transferit të përhershëm, për të cilin proces organi i punësimit na ka dërguar edhe shkresat që argumentojnë këtë çështje.

Andaj, Kolegji duke u bazuar në rrethanat si me lartë vlerëson se objekti i ankesës A.nr.550/2022 të datës 20.06.2022 është i njëjtë me objektin e ankesës së ankuesit A.nr.316/2022 të datës 31.03.2022, për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore, rrjedhimisht objekti i të dy ankesave bazohet në të njëjtën gjendje faktike dhe juridike, kështu që, nisur nga ky konstatim dhe në kuptim të dispozitave të nenit 101 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktikë.*, Kolegji i Këshillit konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore për përfundim të procedurës administrative të filluar me ankesën A.nr.550/2022 të datës 20.06.2022 të parashtruar nga ankuesi

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.550/2022, datë 03.08.2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

